VENDIM
Nr. 129, datë 27.5.2021

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR HEC LUSEN 1, 2, 3, NGA SHOQËRIA "EUROBIZNES" SHPK TE SHOQËRIA "ETE-GRUP-TEKNOLOGJI" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe të nenit 17, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, miratuar ndryshimet me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 215/2019; dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.5.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 76/3 prot., datë 24.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për "Mosfillimin e procedurës për transferimin e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria 'Eurobiznes' sh.p.k. te shoqëria 'Ete-Grup-Teknologji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 675 prot., datë 18.5.2021, shoqëritë "Eurobiznes" sh.p.k. dhe "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k., në cilësinë e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, bashkim ky me shoqëri kryesuese "Eurobiznes" sh.p.k. (pajisur nga ERE me licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 385, seria PV17K), kanë paraqitur kërkesën për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria "Eurobiznes" sh.p.k. te shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k.

- Kërkesa për transferimin e licencës nga shoqëria "Eurobiznes" sh.p.k. te shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k., vjen për arsye se shoqëria "Eurobiznes" sh.p.k. ushtron aktivitete të tjera tregtare dhe shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k. nuk do të ushtrojë aktivitet tjetër përveç prodhimit të energjisë elektrike.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 891/2 prot., datë 23.3.2021, shprehet se: "...konstatojmë se licenca në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lusen 1, 2, 3, është lëshuar në emër të njërit prej anëtarëve të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive 'Eurobiznes' sh.p.k. dhe 'Ete-Grup-Teknologji' sh.p.k. Për sa më sipër, ju informojmë se MIE nuk mund të shprehet lidhur me ndryshimin e mbajtësit të licencës, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lusen 1, 2, 3, nuk është parashikuar miratimi nga ana e MIE-s për zëvendësimin e kërkuar nga ana juaj".

- Në ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) rezulton se, shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k., në objektin e veprimtarisë së saj ka edhe aktivitete të tjera përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Pra, sa pasqyruar në QKB bie ndesh me sa deklaruar vetë nga shoqëria, e cila thotë se nuk do të ushtrojë aktivitet tjetër përveç atij të prodhimit të energjisë elektrike. Përveç sa më sipër, nga QKB-ja rezulton se shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k. është me status "Pezulluar".

- Evidentohet se nuk është kryer pagesa e aplikimit në llogari të ERE-s për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 8, pika 2, i cili citon se: "Aplikuesi duhet të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj

rregulloreje", dhe si e tillë, dokumentacioni i depozituar si me poshtë nuk merret në shqyrtim nga ERE:

- Marrëveshje midis shoqërive "Eurobiznes" sh.p.k. dhe "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k;
- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "Eurobiznes" sh.p.k., datë 10.5.2021;
- Vendim i Ortakut të vetëm të shoqërisë "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k.;
- Informacion në lidhje me transferimin e licencës së ERE-s dhe formati i aplikimit të shoqërisë "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 385, seria PV17K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Lusen 1, 2, 3, nga shoqëria "Eurobiznes" sh.p.k. te shoqëria "Ete-Grup-Teknologji" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqëritë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti